

Data 20.10.2023.

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - MALLRA**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** : “Blerje AUTOMJETE për Nevoja të Bashkise Memaliaj”

**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV :** Automjete 34100000-8

**Fondi limit:** 8,300,000 (tetemilion e treqinde mijë) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Memaliaj ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin e ofertës sipas shtojcës 1:*

*b. Lista e cmimeve të artikujve sipas shtojcës 2;*

*b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8:*

*c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë viteve 2020,2021 dhe 2022 ku vlera mesatare e të tre viteve të jete jo me e vogel se 40 % e fondit limit, të vërtetuar me nje dokument të lëshuar nga administrata tatimore.

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021 dhe 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, ne perputhje me perqindjen dhe/ose natyren e pjesemarrjes ne pune te percaktuar ne aktmarreshje.*

**2.2.3.** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2022**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

**Shenim:** Per kete piken 2.2.3 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, kontratë/a të ngjashme, të kryera dhe të realizuara gjatë tri viteve të fundit në **vlerë jo më e vogël se 20%** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**2.3.1.a** Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontratë/a të shoqëruara me vërtetim/e të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Ose**

**2.3.1.b** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001: 2015** (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) (e vlefshme) **ose ekuivalente e saj.**

Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

**2.3.4** Operatori ekonomik për pajisjen Makineri hidraulike për prerjen e shkurreve duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

**2.3.5** Operatori ekonomik për Kompaktor për mbledhjen e mbeturinave dhe Automjet SUV 4x4 me karrocë duhet të paraqesë Certifikatën e regjistrimit si dhe foto të mjeteve përkatëse, në mënyrë që të bëhet verifikimi sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

**Per automjetin "Kompaktor për mbledhjen e mbeturinave" operatori ofertues duhet të paraqesë:**

1. Librezen e automjetit për të verifikuar përputhshmërinë e automjetit të ofertuar me kriteret e nevojshme për tu përmbushur.
2. Foto të automjetit.
3. Nëse automjeti nuk është në pronësi të ofertuesit, një deklaratë nga pronari i automjetit ku merr përparësi kalimin e automjetit në pronësi të ofertuesit nëse operatori ofertues shpallet fitues.
4. Deklaratë garancie për një periudhë 6 muaj nga data e lëvrimit

**Per automjetin SUV 4 X 4 me karrocë operatori ofertues duhet të paraqesë:**

1. Librezen e automjetit per te verifikuar perputhshmerine e automjtit te ofertuar me kriteret e nevojshme per tu permbushur.
2. Foto te automjetit.
3. Nese automjeti nuk eshte ne pronesi te ofertuesit , nje deklarate nga pronari I automjetit ku merr persiper kalimin e automjetit ne pronesi te ofertuesit nese operatori ofertues shpallet fitues.
4. Nese automjeti i ofertuar nuk eshte ne ngjyre te kuqe (pasi automjeti do te jete ne perdorim te sherbimit zjarrfikes), nje deklarate ku ofertuesi merr persiper nderrimin e ngjyres se automjetit dhe dokumentacionin perkates per kete ndryshim konstruktiv.
5. Deklarate garancie per nje periudhe 6 muaj nga data e levrimit

**Per Makinerine hidraulike per prerjen e shkurreve operatori ofertues duhet te paraqese:**

Kataloget e pajisjes se ofertuar per te mundesuar verifikimin e pajisjes me specifikimet e kerkuara.

1. Deklarate garancie per nje periudhe 1 vite nga data e levrimit
2. OE duhet te marre persiper montimin e funksionim e pajisjes ne mjetin tip CATERPILLAR 428F2.

OE qe do te shpallet fitues duhet te dorezoje mjetet kompaktor per mbledhjen e mbeturinave dhe SUV me te gjithe dokumentacionin e nevojshem per qarkullim (leje qarkullimi , siguracion, kontroll teknik, taksa te paguara) .

***Sipas specifikimeve teknike dhe relacionit bashkangjitur DST.***